



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 14/2011
Prishtinë, më 07.06.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić

Pjesëmarrës të tjerë: Izer Arifi dhe Rifat Kelemendi- MTI; Sabit Gashi dhe Luan Morina – MZHE; Ukë Gashi - ZPRK; Liridon shurdhani Ternsens Slyëka dhe Ardian Kryezi USAID/ BEEP; Haxhi Gashi-USAID/ Deloitte; Fitim Salihu – KDI; dhe Sanije Berisha - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 02.06.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme;
4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-014 për eficiencën e energjisë;
5. Detyrimet e Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropiane, për vitin 2011;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 02.06.2011

Procesverbali nga mbledhjet e datës 02.06.2011 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme

Kryetari – Fillimisht i njoftoj anëtarët e Komisionit se për arsyetimin këtij projektligji ka qënë e ftuara znj.Mimoza Kusari- Lila, ministre Tregtisë dhe Industrisë, në cilësinë e sponsorizuesit të arsyetoj projektligjin. Por, ka njoftuar që nuk mund të jetë e pranishme për arsyeje të agjendës së ngarkuar. Mirëpo, sot kemi të pranishëm përfaqësuesit e MTI-së dhe të projektit të USAID/BEEP që kanë sjell disa rekomandime për ti dhënë sqarimet shtesë. Në vazhdim, kryetari i Komisionit tha që për këtë projektligj raportuese është znj.Teuta Sahatqija, dhe ia kaloj fjalën për të paraqitur Raportin me propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme.

Teuta Sahatqija - tha së Grupi punues ka shqyrtuar këtë projektligj, dhe është takuar disa here, dhe kemi pasur një bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Projektit të USAID/BEEP, Komisionit Evropian dhe me Njësinë mbështetse të Komisionit. Theksoj se në shumicën e amendamenteve jemi pajtuar. Arsyeja pse kemi kërkuar sqarime shtesë nga MTI- ja është sepse po kemi shumëfishim të inspektorateve, të çështja e gjobave që janë shumë të larta dhe të kryeinspektorit i ipen kompetenca të tepruara për të marr vendimin për gjobat. Poashtu shtoj se ky projektligj ka implikime edhe me ligjet tjera si me ligjin për shoqëritë tregtare dhe ligjin për mbrojtjen e konkurrencën. Andaj ne qoftë se dëshirojmë ta krijojmë një ambient me të mirë për biznes, atëherë duhet ti kemi parasysh që më këto gjoba të larta mund ti dërgojmë në mbyllje bizneset e jo ti stimulojmë.

Vërejtjet ne Amendamente

Amendamenti 6

Teuta Sahatqija – theksoj se gjbat e parashikuara ne Nenin 12 qe ndryshon Nenin 60 te Ligjit te fuqi jane shume të larta dhe kërkoj nga Komisioni që në këtë Nen të këtë ndërhyrje.

Liridon Shurdhani USAID/BEEP – theksoj se projekti i USAID e përkrah këtë projektligj dhe duhet të miratohet për shkak së i duhet vendit për një biznes me ambient më të mirë.

Ramiz Kelmendi – theksoj po ashtu se janë gjoba mjaft të larta dhe duhet të ulen deri në atë mase sa ti ndihmohet biznesi e jo te ngulfatët.

Hashim Deshishku – përkrahu mendimin e z.Kelmendi ku theksoj se janë të papërbalueshme këto gjoba për biznes.

Kryetari – theksoj se pajtohet se gjobat janë të larta mirëpo duhet të shikohet edhe ana tjetër e të mirës që ka gjoba për shkak së luftohet ekonomia joformale.

Myzejene Slemani – theksoj se ky paragraf duhet te fshihet ne tërësi sepse shqiptimi i gjobave është kompetencë e inspektoratit dhe kjo çështje rregullohet me Ligjin përkatës për inspektoratin.

Visar Ymeri – theksoj se nëse duhet të kemi zbatim sa më të plotë të Ligjit duhet edhe të kemi sanksione që parashihen për ata që bejnë shkelje te Ligjit.

Sala Berisha – Shala – theksoj se e përkrah mendimin e z.Ymeri, përveq që kërkoj që të specifikohet qartë masa e ndëshkimit e jo të jetë në këtë formë prej 3000 deri ne 9000 euro.

Ramiz Kelmendi – perseriti propozimin e tij qe të ulen sa më shumë te jete e mundur këto gjoba, sepse dënimi prej 3000 deri ne 9000 euro janë shumë për biznes të vogel. Po ashtu denimi për personin fizik është i madh dhe dënimi duhet te jëtë në përputhje me te ardhurat për kokë banori.

Teuta Sahatqija – propozoj që denimi të jetë 1000 deri ne 3000 euro për personin juridik ndërsa denimi prej 200 deri në 500 euro për personin fizik.

Propozimi u përkrah më vetëm 1 votë kundër të z.Kelmendi, si në vijim:

Neni 12, ndryshohen gjobat ne Nenin 61 te Ligjit ne fuqi si vijon:

“3.000 € deri 9.000 €” bëhen “1000 € deri ne 3000 €”; dhe

“1.000 deri 3.000 € “ bëhen “200 € deri ne 500 €”.

Amendamenti 7

Teuta Sahatqija – theksoj se po ashtu edhe ne Nenin 13 i cili ndryshon Nenin 61 të Ligjit ne fuqi gjobat e propozuara janë të medha dhe bëri thirrje të ulen.

Liridon Shurdhani USAID/BEEP – theksoj se projekti i USAID e përkrah këtë projektligj dhe duhet të miratohet për shkak së i duhet vendit për një biznes më ambient më të mirë.

Ramiz Kelmendi – theksoj se edhe këto gjoba janë mjaft të larta dhe kërkoj të ulën në mënyrë që ti ipet fuqi biznesit të vogel sa më shumë të jetë e mundur.

Myzejene Selmani – theksoj se edhe me heret edhe ne lexim të parë, kam rekomanduar që edhe ky projektligj duhet ti kthehet për ripunim ministrisë sepse është në kolizion të plotë më ligje tjera.

Hashim Deshishku – theksoj se duhet të këtë denime sepse kemi të bëjmë më mallra që ekspozohen jashtë dhe është në pyetje shëndeti i qytetarve.

Sala Berisha – Shala – theksoj se nuk ka lidhje pse është ligji tjetër dhe që parashihen edhe inspektorate tjera. Ky ligj është specifik dhe duhet të miratohet. Propozoj qe në paragrafin 1.1 dhe 1.4 të hiqen fjalët “dhe nuk është i regjistruar” dhe ne paragrafin 1.4 të jëtë pas ndëshkimit sipas paragrafit 1.1 te Nenit 61 te Ligjit ne fuqi.

Hashim Deshishku – propozoj qe ne paragrafin 1.4 gjobat 5000 deri ne 15000 te ulen ne 4000 deri ne 8000.

Ramiz Kelmendi - propozoj qe ne paragrafin 1.4 gjobat 5000 deri ne 15000 te ulen ne 1000 deri ne 3000.

Propozimi i deputetes Sala Berisha – Shala dhe deputetit Hashim Deshishku u përkrahen, më vetëm 1 votë kundër të z.Kelmendi, si në vijim:

Neni 13, numrat paragrafëve të rishkruhen sikurse janë në Ligjin në fuqi (61.1).

Paragrafi 1.1 dhe 1.3 i Nenit 61 të Ligjit në fuqi, fshihet togfjalëshi “dhe nuk është i regjistruar,”

Paragrafi 1.4 i Nenit 61 të Ligjit në fuqi, ndryshohet si vijon:

1.4. Me gjobe në shume prej 4.000,00 € deri 8.000,00 € ndëshkohet personi juridik për kundërvajtje për shkak të shitjes në ambient të hapur, pas shqiptimit të gjobës së parë sipas paragrafit 1.1 të këtij neni;

Pas debatit, Komisioni me 9 vota Për, 1 votë Kundër të deputetit Ramiz Kelmendi dhe 1 abstenim të deputetes Myzejene Selmani, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme, dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme.

4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-014 për eficiencën e energjisë;

Kryetari- tha që për këtë Projektligj raportues është z.Berat Buzhala, dhe ia kaloj fjalën për të paraqitur Raportin me propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-014 për eficiencën e energjisë.

Berat Buzhala - tha se Grupi punues ka punuar në tri takime dhe ka bashkëpunuar shumë ngushtë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe më Shoqërinë civile si Instituti GAP, KIPRED etj. Pastaj paraqiti amendamentet si në vijim: **Amendamenti 1** ndryshon Nenin 1; **Amendamenti 2** riformulon Nenin 2; **Amendamenti 3** riformulohet neni 3 nënparagrafi 1.2; **Amendamenti 4** riformulohen neni 4 nënpragrafet 1.1 1.4 dhe paragrafi 2; **Amendamenti 5** ndryshon neni 5; **Amendamenti 6** ndryshohet neni 6 nënpragrafet 1.1 dhe 1.4; **Amendamenti 7** ndryshohet neni 7 paragrafi 2; **Amendamenti 8** ndryshohet neni 8; **Amendamenti 9** ndryshohet neni 9; **Amendamenti 10** riformulohet neni 11 paragrafi 1 dhe 2; **Amendamenti 11** ndryshohet neni 13; **Amendamenti 12** ndryshohet neni 14; dhe **Amendamenti 13** riformulohet neni 15 paragrafi 1 dhe 2.

Vërejtjet në amendamente

Amendamenti 4

Sala Berisha – Shala – pyeti se kush e dërgon Planin në Qeveri?

Berat Buzhala – Planin në Qeveri e dërgon Ministria.

Amendamenti 4 nuk u ndryshua.

Amendamenti 9

Hashim Deshishku – pyeti se Planet a janë të komunës apo të Agjencisë?

Sabit Gashi MZHE – tha se këto Plane rregullohen më një akt nënligjor. Dhe aty pastaj caktohet e tërë procedura.

Amendamenti 4 nuk u ndryshua.

Ramiz Kelmendi – pyeti se a ka ndëshkime për moszbatimin e këtij ligji?

Sabit Gashi MZHE – tha nuk ka ndëshkime sepse ky ligj ka karakter promovues.

Berat Buzhala – për krejt fushëveprimin e këtij ligji është përcaktuese Direktiva e BE-së, ku në të janë të qarta të gjitha politikat për efikasitetin e energjisë.

Visar Ymeri – pyeti se si është rregulluar çështja e Fondit për efikasitetin e energjisë dhe çështja përfaqësimit edhe të sektorit privat sepse projektligji obligon vetëm sektorin publik?

Sabit Gashi MZHE – tha shkak i atij Fondi është miratimi i këtij projektligji. Po ashtu më miratimin e këtij ligji tani ne si Kosovë jemi në rregull sa i përket obligimeve që dalin nga Traktati ku jemi pjesë e tij. Edhe çështja e sektorit privat tani është e rregulluar më këtë ligj.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit nr.04/L-014 për efikasitetin e energjisë, dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme.

5. Detyrimet e Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011

Kryetari – theksoj se ne baze të detyrimeve që ka Komisioni në kuadër të Planit të veprimit, duhet të ftohen të gjithë ministrat që përfaqësojnë ministratë përkatëse që bien nën mbikëqyrjen e Komisionit, të raportojnë në Komision. Për këtë në të njëjtin raport ministri i zhvillimit ekonomik dhe pastaj do ftohen edhe ministrat tjerë. Po ashtu Komisioni duhet të bëjë organizimin e një dëgjimi mbikëqyrës të ministrave të MTI në lidhje me CEFTA. Në vazhdim kryetari tha që lidhur me këto detyrime të Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011 ka për obligim ta bëjë monitorimin e ligjit për Minierat dhe Mineralet Nr. 03/ L- 163 dhe propozoj të formohet një grup punues prej 5 anëtarëve për monitorimin e Ligjit për Minierat dhe Mineralet Nr. 03/ L- 163

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- I. Komisioni autorizoi Kryetarin që të mbikëqyrë zbatimin e Planit të veprimit dhe detyrimet që dalin nga Raporti i Progresit për Komisionin;
- II. Kryetari në koordinim me Komisionin për Integritet evropian të Kuvendit dhe Komisionin Evropian të këtë raportime të rregullta për progresin e arritur.

Po ashtu Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

- I. *Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Minierat dhe Mineralet Nr. 03/ L- 163;*
- II. *Grupi punues ka këtë përbërje: Sala Berisha – Shala raportuese, Fikrim Damka, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Visar Ymeri anëtarë;*
- III. *Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

5. Të ndryshme.

a) Mbledhja e radhës

Kryetari –i njoftoj anëtarët e Komisionit që më datën 08.06.2011, në bazë të Planit të punës është i ftuar z. Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit ekonomik, në takim që të raportoj në Komision për punën dhe aktivitetin e ministrisë që drejton.

b) Aktivitetet e radhës të Komisionit;

Kryetari – i njoftoi anëtarët e Komisionit që datë 09.06.2011 do të vizitojnë Trepçën, për një takim punë rreth aktiviteteve dhe funksionimit të Trepçës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit**